


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Poloninë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Poloninë¹, për vitin 2025, deficitin tregtar ka shënuar një rritje prej 30.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke u rritur në -269.2 milionë euro nga -205.7 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti është simbolike rreth 1.3%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Poloninë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	5.8	5.6	2.9	3.5
Import	135.1	140.4	208.6	272.7
Bilanci tregtar	(129.3)	(134.8)	(205.7)	(269.2)
% e mbulimit	4.3%	4.0%	1.4%	1.3%
Rritje Exp. (v-m-v) %	259.9%	-4.3%	-47.6%	20.0%
Rritje Imp. (v-m-v) %	2.7%	3.9%	48.6%	30.7%
Bila. Treg. (v-m-v) %	-0.5%	4.3%	52.6%	30.9%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


¹ Polonia, zyrtarisht Republika e Polonisë, është një vend në Evropën Qendrore, me kryeqytet Varshavën. Ka një sipërfaqe prej 312,696 km², me rreth 37.4 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) nominal për vitin 2025 vlerësohet rreth 1,04 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 28,485 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 20-të sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave me Poloninë, Kosova ka një deficit tregtar të thellë dhe në rritje të vazhdueshme me këtë vend të BE-së, i cili u dyfishua nga viti 2022 në vitin 2025.

Gjatë kësaj periudhe Eksportet e Kosovës me Poloninë mbeten në nivele shumë të ulëta (nën 6 milionë euro), duke pësuar rënie të ndjeshme në vitin 2024. Ndërsa Importet kanë shënuar rritje të hovshme, duke kërcyer nga 135.1 milionë euro sa ishin në vitin 2022 në 272.7 milionë euro në vitin 2025.

Importet nga Polonia (në sasi dhe në vlerë) dominojnë dukshëm ndaj eksporteve të Kosovës, duke reflektuar varësinë relativisht të madhe të tregut kosovar nga produktet polake. Si rezultat i këtij trendi vitet e fundit, përqindja e mbulimit të importeve me eksporte ka rënë nga 4.3% në vitin 2022, në vetëm 1.3% në vitin 2025.

Figura 2. Eksport/Importi me Poloninë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Poloni ishin rreth 3.5 milionë euro apo rreth 0.4% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.

Importi i mallrave nga Polonia arritën në 272.7 milionë euro apo 3.9% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e 8-ta në listën e vendeve kryesore të importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Poloni në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 37.5% Artikuj të ndryshëm të prodhuar(mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 19.4% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi; 10.3% Tekstil dhe artikuj tekstili; 8.9% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 7.0% Produkte bimore; 6.7% Produkte të industrisë kimike; 5.4% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre, etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Poloninë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)


Rritja e eksporteve për 20.0% apo rreth 0.6 milionë euro më shumë mallra në tregun polak në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si, Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj) (nga 17.6% në 37.5%), Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi (nga 4.8% në 19.4%) dhe te Tekstil dhe artikuj tekstili (nga 2.5% në 10.3%).

Eksportet e Kosovës drejt Polonisë karakterizohen me luhatje nga sektori në sektor, me një përqendrim i lartë te disa sektorët kryesorë (produkte minerale-kryesisht xeherore dhe koncentre zinku; artikuj të ndryshëm të prodhuar si mobileri, krevat, dyshek dhe produkte bimore) përbëjnë rreth 70.5% në vitin 2024, ndërsa në vitin 2025 rreth 67.2% në të vlerës totale të eksportuar janë nga sektorë (artikuj të ndryshëm të prodhuar si mobileri, krevat.; artikujt prej guri, allçie, keramike., dhe tekstil). Transformimi i strukturës së eksportit në vitin 2025, me një rritje të madhe te sektorit të artikujve të prodhuar (mobileri) nga 17.6%

në vitin 2024 në 37.5% në vitin 2025, dëshmon për një zhvendosje pozitive drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar krahasuar me lëndët e para minerale të vitit paraprak

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 52.5% Ushqime të përg. pije, pije alkoolike dhe duhan; 11.9% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 7.1% Produkte të industrisë kimike; 4.8% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 4.4% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe; 4.3% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.0% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi; 3.7% Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk..) etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Polonia.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës (DK)

Rritja e importeve për 30.7% apo rreth 64.1 milionë euro më shumë mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Ushqime të përg. pije, pije alkoolike dhe duhan dhe të Makineri, paisje mekanike dhe elektrike.

Dominimi i ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit, me rreth 46.8% vitin 2024 dhe rreth 52.5% në vitin 2025 të vlerës totale në strukturën e importeve, tregon varësinë e theksuar të tregut të konsumit kosovar nga këto prodhime polake. Kjo parqet një hapësirë të madhe për investime në industrinë vendore të përpunimit të ushqimit dhe mundësinë për të hartuar e zbatuar politika zhvillimore në drejtim të rritjes së prodhimit vendor dhe uljen e varësinë nga produktet e importuara.